



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:166564
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05514505
C.nr.529/2020

GJYKATA THEMELORE MITROVICË –DEGA NË SKENDERAJ- Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.D. nga fshati..., komuna Skenderaj, me nr. personal... te cilin e përfaqëson me autorizim Sh.I. avokat ne Skenderaj, Rr..., kundër të paditurve F.H. nga fshati..., komuna Skenderaj, dhe H.Th. nga fshati..., komuna Skenderaj, tani me vendbanim Rr... ne Skenderaj, për vërtetim pronësie ne bazë te shitblerjes se paluajtshmerisë, jashtë seancës gjyqësore , me dt.27.03.2024 jep këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET kërkesëpadia e paditësit I.D. nga fshati... komuna Skenderaj.

II. VERTETOHET se paditësi I.D. është pronar nga baza e shitblerjes ne pasurin e paluajtshme e evidentuar si ngastër kadastrale nr... me kulturë arë ne vendin e quajtur... me sipërfaqe prej 8286 m2, zona kadastrale..., komuna Skenderaj,

III. DETYROHEN te paditurit F.H. dhe H.Th., t'ia njohin të drejtën e pronësisë paditësit I.D., dhe te lejojë qe kjo e drejte te regjistrohet ne librat publike kadastrale ne Drejtorin për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë ne Skenderaj, ne afat prej 15 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi e nen pasojat e procedurës përmbaremore.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi I.D. në këtë gjykatë ka parashtruar padi me dt:26.11.2020 kundër të paditurve F.H. dhe H.Th. ,për vërtetim pronësie nga baza e shitblerjes se paluajtshmerisë.

Nga referati i padisë theksohet se paditësi pasurinë e paluajtshme e ka blere nga prindi i te paditurve dhe ka marrë për obligim bartjen e pronësisë ne emrin e tij por ne ndërkohe ka vdekur dhe paditësi e ka ne shfrytëzim dhe mbajtje te pa ndërprerë ketë paluajtshmeri, pasi qe e kishte paguar çmimin e shit blerjes pra është ne posedim te qetë dhe faktikë, mirëpo ka interes juridik qe kjo paluajtshmeri te bartet ne emrin e tij me propozim gjykatës qe te aprovohet kërkesë padia ne tersi si e bazuare.

Te paditurit ne përgjigje ne padi te dorëzuar ne gjykatë kanë deklaruar se bazuar ne gjendjen faktike kjo padi është e bazuar ne tersi dhe ne petitumin e te njëjtës te dhënat janë te vërteta pasi

qe është fakte qe këtë pasuri te paluajtshme paditësi e ka blere nga prindi jonë dhe prej ati momenti te shitblerjes e ka ne shfrytëzim te qete dhe mbi këtë bazë unë nuk e kontestoi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit.

Gjykata pa shqyrtim te mëtejme jep aktgjykim ne bazë te pohimit ne kuptim te nenit 143 parag.1, e lidhur me nenin 398 Ligji i Procedurës Kontestimore me te cilin e pranon si te bazuare kërkesë padinë.

Gjykata vendosi si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi pasi qe vlerësoi se themelësia e kërkesë padisë është vërtetuar ne faktet e treguara ne padi mbi te cilat mbështetët kërkesë padia, pra nuk janë ne kundërshtim me provat qe i ka propozuar vete paditësi, si qeshte certifikata e pronësisë te dt:27.10.2023, qe vërtetohet se ngastra kadastrale qe është çështje shqyrtimi evidentohet ne emrin Z.Th., si rrethana te vërtetuara nga i padituri pra ka legjitimitet pasivë te palës ne procedure pasi qe i padituri e ka pohuar kërkesë padinë dhe ka lejuar qe kjo prone te bartet ne emër te paditësit.

Nga provat e pa kontestauara gjykata erdhi ne përfundim se kërkesë padia e paditësit është e bazuar ne kuptim te nenit 28 te Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore dhe nenit 36 te Ligjit për Pronësinë dhe te Drejtat Tjera Sendore, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Ne kuptim te nenit 160.6 te Ligji i Procedurës Kontestimore gjykata dha vetëm arsyet e marrjes se këtij aktgjykimi pa u lëshuar ne arsyesherinë e secilës veç e veç e këtë për faktin se i padituri e ka pohuar kërkesë padinë e paditësit dhe me qen se kemi te bëjmë me kërkesa për te cilat palët mund te dispononi lirshëm e nuk janë ne kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 3 parag3 i lidhur me nenin 148 parag1 dhe neni 398 Ligji i Procedurës Kontestimore vendosi si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi ne kuptim te nenit 450 te Ligji i Procedurës Kontestimore, ashtu që secila palë i bart shpenzimet e veta në procedurë.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.529/2020 me dt.27.03.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.